

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KESHILLI

Nr. 5779 / Prot.
7

Pogradec, më 30 . 12 .2022

VENDIM

NR. 146 , DATË 28 . 12 .2022

PER

MBESHTETJEN PER MEMORANDUMIN E BASHKEPUNIMIT ME PROJEKTIN “BASHKI TE FORTA II” DHE AUTORIZIM I KRYETARIT TE BASHKISE POGRADEC PER FIRMOSJEN E KETIJ MEMORANDUMI

Bazuar në ligjin 136/2015 “Për vetqeverisjen vendore” dhe në përputhje me Rregulloren e Këshillit Bashkiak Pogradec”, projekti “Bashki te Forta II”, një program I financuar nga Qeveria Zviceriane dhe implementuar nga HELVETAS Swiss Intercooperation Albania, për gjatë periudhës 2023-2026, do të vazhdojë të forcojë këshillat bashkiakë dhe të përmirësojë shërbimit e menaxhimit të mbetjeve dhe të arsimit parashkollor. Projekti do të mbështesë aktorët e sistemit për të rënë dakord për standardet minimale të përballeshme për ofrimin e shërbimeve dhe qeverisjen e mirë. Projekti do të intensifikojë ndërhyrjet e tij në fushën e performancës, duke ngritur një system të menaxhimit të performancës në mbarë vendin, i cili do të plotësohet edhe nga një skeme granti e bazuar në performancë, në pjesën e dytë të periudhës së këtij projekti. Thënë sa me lart dhe në vijim të bashkëpunimit të Bashkisë Pogradec me projektin Bashki të Forta;

Këshilli I Bashkisë Pogradec, në mbledhjen e datës 28.12.2022.

VENDOSI:

1. Të miratojnë mbështetjen për Memorandumin e Bashkëpunimit me projektin “Bashki të Forta II” dhe autorizojë Kryetarin e Bashkisë për firmosjen e këtij memorandumi.
2. Për zbatimin e këtij Projekt-Vendimi, ngarkohet Kryetari i Bashkisë Pogradec.
3. Ky Projekt-Vendim hyn nëfuqi, në mbështetje të Ligjit 139/2015 të Vetëqeverisjes Vendore.

KRYETARI I KËSHILLIT
Sotiraq MANGËRI





Memorandum Bashkëpunimi
Mbështetje për Zhvillim 2022-2024
Bashki të Forta
Bashkia Pogradec

Ndërmjet **Bashki të Forta (BtF)**, një projekt i Zhvillimit dhe Bashkëpunimit Zviceran i zbatuar nga Helvetas Swiss Intercooperation (në vijim BtF dhe Helvetas), i përfaqësuar nga Z. Norbert Pijls, Menaxher i Projektit.

dhe **Bashkia Pogradec**
në vijim Njësia e Vetëqeverisjes Vendore (NJVQV) e përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë Z. Ilir Xhakolli, në baze të vendimit të Keshillit Bashkiak

1. HYRJE

Programi për Decentralizim dhe Zhvillim Vendor Bashki të Forta është një projekt financiar nga Qeveria Zvicerane që mbështet 61 Njësi të Vetëqeverisjes Vendore në të gjithë Shqipërinë. Projekti ofron asistencë teknike dhe grante të performancës, synon shtrirje kombëtare dhe do të bazojë mbështetjen e tij në kërkesat e bashkive.

Kuadri Ligjor Baza ligjore për këtë Memorandum Bashkëpunimi është një marrëveshje e përgjithshme qeveri-me-qeveri ndërmjet Konfederatës Zvicerane dhe Qeverisë së Shqipërisë. Partneri kryesor i projektit në nivel nacional është Ministria e Brendshme (MB) që vepron përmes Agjencisë për Mbështetjen e Vetë-qeverisjes Vendore (AMVV). MB/AMVV koordinon aktivitetet dhe vendimarrjen e saj në kuadër të këtij projekti me Ministrinë e Financave (MF).

Dokumenti i Programit BtF 1.3. Elementet kryesore të Dokumentit të Programit BtF 2 dhe Planit Vjetor Operacional janë identifikuar në mënyrë pjesëmarrëse dhe miratuar nga Komiteti Drejtues i cili bashkëkryesohet nga Ministria e Brendshme dhe Zhvillimi dhe



Projekti BtF

Bashkëpunimi Zviceran. Dy dokumentet janë baza për këtë Memorandum

1.4 Qëllimi kryesor i BtF-së është që “qytetarët në Shqipëri të përfitojnë nga përmirësimi i qeverisjes dhe ofrimit të shërbimeve në nivel bashkie, sipas standardeve minimale dhe të përballueshme të dakordësuara për një sistem të qëndrueshëm kombëtar”.

Veprimtaritë kryesore në Dokumentin e Programit lidhen me 3 fusha pune:

- (1) Përmirësimi i shërbimit (menaxhimi i mbetjeve dhe arsimit parashkollor);
- (2) Mbështetja e Këshillit Bashkiak;
- (3) Menaxhimi i performancës (përfshirë grantin e performancës).

Memorandumi i Bashkëpunimit

1.5 NJVQV-ja e nënshkruar dhe Bashki të Forta shprehin vullnetin dhe angazhimin e tyre për të bashkëpunuar në kuadrin e Dokumentit të Programit (2) dhe kuadrin të rezultateve (shih dokumentin bashkëngjitur i cili i nënshtrohet rishikimit vjetor) dhe shkëmbejnë në mënyrë aktive në fushën tematike të paracaktuar dhe të rënë dakord sipas kërkesës së NJVQV-së.

FUSHAT KRYESORE TË BASHKËPUNIMIT DHE MBËSHTETJES

Fushat e Bashkëpunimit dhe Mbështetjes

2.1 Fushat e bashkëpunimit dhe mbështetjes përfshijnë objektivat e mëposhtme:

- Administratat bashkiake përmirësojnë ofrimin e shërbimeve (menaxhimi i mbetjeve dhe arsimit parashkollor) drejt standardeve më të përshtatshme dhe më të përballueshme.
- Këshillat bashkiake mbikëqyrin në mënyrën e duhur performancën e administratës bashkiake dhe angazhohen në vendimmarrje të bazuara në të dhëna.
- Ekziston një sistem i ri i menaxhimit të performancës bashkiake dhe një



mekanizëm granti i bazuar në performancë.

Temat transversale: Barazia Gjinore, përfshirja sociale dhe ndryshimet klimatike do të përfshihen në të gjithë elementët.

KONTRIBUTUTET DHE DETYRAT E NJVQV-VE PARTNERE DHE PROJEKTIT “BASHKI TË FORTA”

Pjesëmarrja dhe kontributi për veprimtaritë

Bashkëpunim dhe mbështetje aktive për të gjitha veprimtaritë e programit:


- Pjesëmarrja dhe bashkëfinancimi i përfaqësuesve/anëtarëve të stafit përkatës politikë në takime, seminare, shkëmbime, trajnime, vizita studimore dhe ngjarje të tjera të organizuara në kuadër të Projektit BtF nga aktorë të sistemit të angazhuar në ngritjen e kapaciteteve dhe ndryshimet e politikave.
- Bashkëfinancimi i veprimtarive/projekteve, aty ku është rënë dakord.
- Lidhja në mënyrë aktive e të gjitha veprimtarive të projektit me ciklin e planifikimit dhe raportimit të NJVQV-së (planifikimi i burimeve njerëzore dhe financiare, procesi i planifikimit dhe buxhetimit).

Bashkëpunimi i ngushtë me Koordinatorët Rajonal të Projektit, krijimi i qasjes për to dhe dhënia e feedback-ut për performancën e tyre.

Anëtarësimi në Rrjete leadership-i dhe tematike

Shkëmbimi në kuadër të rrjeteve të leadership-it dhe atyre tematike:

Kryetarët e bashkive, kryetarët e këshillave bashkiake dhe ekspertët tematikë vendorë të caktuar do të marrin pjesë rregullisht në rrjetet e drejtuesve dhe ekspertëve ndërmjet NJVQV-ve dhe do të zhvillojnë më tej kapacitetet e tyre të cilat do të përdoren për zbatimin e masave të përzgjedhura në përmirësimin e shërbimit (menaxhimi i mbetjeve dhe arsimit parashkollor).



menaxhimin e performancës dhe veprimtarinë e këshillit bashkiak.

NJVQV-ja u siguron atyre burime të mjaftueshme për detyrat e tyre dhe projekti "Bashki të Forta" do të mbështesë dhe asistojë zbatimin tematik të veprimtarive të rrjetit.

Kriteret për përfituesit e drejtpërdrejtë

NJVQV-të mund t'i qasen mbështetjes së projektit "Bashki të Forta" duke:

- (a) shprehur interesin e tyre nëpërmjet nënshkrimit të këtij Memorandumi Bashkëpunimi;
- (b) marrë pjesë në skema të ndryshme të bazuara në performancë të ndërmarra nga qeveria shqiptare (si konkursi i praktikave të mira, grantet e performancës etj.)

marrë pjesë në platforma (p.sh. zyrat e informacionit, trajnime, konsultime etj.) të ndërmarra nga aktorët kombëtarë që mbështesin ngritjen e kapaciteteve, përmirësimin e politikave dhe përmirësimin e performancës.

Detyrat për përfituesit e drejtpërdrejtë dhe mbështetja e ofruar nëpërmjet projektit "Bashki të Forta"

3.4.Për NJVQV-në dhe për projektin "Bashki të Forta" janë parashikuar këto detyra:

NJVQV-ja zotohet të:

Projekti "Bashki të Forta" ofron:

Angazhohet për të pilotuar standardet kombëtare të shërbimit në menaxhimin e mbetjeve dhe arsimin parashkollor, të marrë pjesë në mënyrë aktive si anëtare e Shoqatës së NJVQV-ve në vleftësimin e tyre dhe të zbatojë udhëzimet e nxjerra për këtë qëllim nga niveli kombëtar.

Asistencë logjistike dhe teknike, platformë diskutimi

Angazhojë koordinatorin e informimit të publikut/ departamentit të IT-së dhe shërbimeve (përfshirë mediat sociale dhe kanalet e internetit) për të hartuar,

Modelim, bashkëhartim dhe bashkëfinancim i fushatave



zbatuar, bashkëfinancuar dhe monitoruar fushatat me në qendër qytetarin.

Ndërmarrë konsultimin/informimin publik dhe anketimin e qytetarëve sipas ligjit dhe rregulloreve të këshillit bashkiak për të gjitha inputet e nevojshme në dy shërbimet e përzgjedhura.

Asistencë teknike për inputet e zgjedhura

Përmirësimi i Shërbimit (menaxhimi i mbetjeve dhe arsimit parashkollor)

Përzgjedhë masat sipas kërkesës dhe t'i zbatojë ato për përmirësim në shërbimet e menaxhimit të mbetjeve dhe arsimit parashkollor.

Trajnim, Anëtarësim në Rrjetin Tematik, Trajnim në Punë

Planifikojë burimet/masat e paketës fiskale (nëse nevojitet) për të mbështetur masat e përzgjedhura për përmirësimin e shërbimit.

Asistencë teknike për të përcaktuar koston dhe tarifën e shërbimit

Sigurojë pjesëmarrjen e stafit në kurset përkatëse të trajnimit për menaxhimin e mbetjeve dhe arsimit parashkollor.

Bashkëfinancim, platformë diskutimi

Menaxhimi i Performancës

Institucionalizojë njësinë e performancës bazuar në udhëzimet e nxjerra.

Asistencë teknike për njësinë e performancës përmes BtF-së dhe aktorëve të sistemit kombëtar

Hartojë dhe miratojë në këshillin bashkiak raportin e performancës dhe sigurojë qasjen e publikut në raport.

Asistencë teknike për raportin e performancës vendore dhe anketimin e qytetarëve nëpërmjet BtF dhe aktorëve të sistemit kombëtar

Hartojë dhe miratojë në këshillin bashkiak një anketim të qytetarëve dhe sigurojë qasjen e publikut në rezultatet e anketimit.

Zyra e informacionit pranë Shoqatave/AMVV/MFmbi menaxhimin e performancës

Kontribuojë si anëtare e Shoqatës së Qeverisjes Vendore, në vlefësimin e një

Qasje në një skemë grantesh të bazuar në performancë të bashkëfinancuar nga Qeveria



sistemi të menaxhimit të Shqiptare (2025)
performancës (duke
përfshirë skemën e granteve
dhe udhëzime për njësinë e
performancës dhe
metodologjinë e vendosjes
së standardeve.

Sigurojë pjesëmarrjen e stafit Bashkëfinancim, platformë
në kurset përkatëse të diskutimi
trajnit për performancën.

Mbështetje për këshillin bashkiak

Përdorë pajisje për të Pajisje dhe trajnim në punë
transmetuar mbledhjet e
këshillit bashkiak dhe për të
ndjekur komentet e
qytetarëve bazuar në
rregulloret e këshillave
bashkiake.

Ankorojë regjistrat e
ankesave, kërkesave dhe
nismave të qytetarëve në
faqen e internetit të
bashkisë.

Hartojë, miratojë, zbatojë,
monitorojë dhe raportojë
planin vjetor të punës dhe
buxhetin e këshillit, si dhe t'i
vendosë ato (planin dhe
raportimin) në dispozicion të
publikut (theks i veçantë në
konsultimin publik).

Sigurojë mbështetje për
këshillin bashkiak nëpërmjet
koordinatorit të informimit të
publikut dhe stafit të TIK-ut,
të paktën duke përditësuar
rregullisht faqen e internetit
të këshillit bashkiak, duke
përmirësuar kësisoj renditjen
e barometrit të internetit.

Ndërtojë procese/procedura
të brendshme ndërmjet
administratës dhe këshillit
bashkiak bazuar në
rregulloret/ligjet e këshillit
bashkiak.

Trajnim në punë/mjete dhe
modele



Sigurojë që këshilli bashkiak të respektojë udhëzimet e AMVV-së në lidhje me kriteret për sekretaritë dhe sekretarët bashkiakë.

Marrë pjesë në kursin hyrës për anëtarët e këshillit bashkiak dhe bashkëfinancojë atë. Bashkëfinancim, platformë diskutimi

Gjallërojë komisionin e barazisë gjinore të këshillit bashkiak dhe aleancën e grave (përfshirë zgjedhjen e Aleancës kombëtare të grave) pas zgjedhjeve. Moderim, platformë diskutimi dhe asistencë teknike

Promovojë përfshirjen gjinore dhe sociale, veçanërisht në procesin e buxhetimit dhe avokojë për to në nivel kombëtar.

Shpërndarja brenda NJVQV-së

3.5 NJVQV-ja angazhohet për shpërndarjen e informacionit, njohurive dhe të nxënimit brenda NJVQV-së.

Ndarja e informacionit

3.6 Ndarja e të gjithë informacionit, përvojës dhe dokumenteve përkatëse me projektin "Bashki të Forta" si dhe me partnerët e tjerë (duke përfshirë nisma dhe programe të tjera në vazhdim në NJVQV), të cilat janë të nevojshme dhe të rëndësishme për arritjen së bashku të synimeve dhe objektivave të përcaktuara.

Bashkërendimi i veprimtarive të donatorëve dhe projekteve të tjera të investimeve

3.7 Bashkërendimi i veprimtarive dhe programeve të ndryshme të donatorëve brenda NJVQV-së, për të krijuar parakushte për sinergji dhe shfrytëzim maksimal të burimeve ekzistuese.


KUSHTET E PËRGJITHSHME

Vlerësimi i rishikimit afatmesëm i bashkëpunimit

Një vlerësim afatmesëm i cilësisë së bashkëpunimit - pra përmbushja e detyrave dhe kontributeve kryesore - do të shërbejë si bazë për vendimin për mbështetjen dhe bashkëpunimin e ardhshëm. Projekti "Bashki të Forta" angazhohet të ndërmarrë çdo rishikim që mund të shprehë vullnetin e lidhshëm të ri pas zgjedhjeve vendore.

Monitorimi nga projekti "Bashki të Forta"

NJVQV-ja do të sigurojë që Helvetas-i, SDC-ja ose një palë e tretë e autorizuar prej tyre, mund të monitorojë dhe inspektojë zbatimin dhe ecurinë e programit në çdo mënyrë



që ata e gjykojnë të dobishme (kontakte personale, shqyrtim i dokumenteve, auditim i llogarisë së projektit, etj.). Helvetas-i rezervon të drejtën të ndërhyjë në rast vështirësish për të përmirësuar zbatimin e programit.

Keqpërdorimi i fondeve dhe klauzola anti-korrupsion

Në rast dyshimi për keqpërdorim të fondeve dhe/ose korrupsion, do të zbatohen rregullat dhe rregulloret e Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), të cilat mund të përfshijnë bllokimin e menjëhershëm të aseteve dhe llogarive, dhe procedura penale ose civile kundër palëve të përfshira.

Përfundimi i Projektit

Projekti "Bashki të Forta" do të ketë të drejtën të ndërpresë çdo projekt për arsye të tilla si vonesa të tepërta kohore, menaxhim jokompetent i projektit, cilësi jo të kënaqshme, mashtrim dhe korrupsion, forcë madhore, etj. Helvetas-i është i gatshëm të diskutojë arsyet e një vendimi të tillë me NJVQV-në.

Modifikimet

Modifikimet dhe ndryshimet që konsiderohen se janë bërë të dëshirueshme gjatë zbatimit të projektit duhet t'i paraqiten projektit "Bashki të Forta" me shkrim për diskutim dhe mund të zbatohen vetëm nëse miratohen nga Helvetas Shqipëri.

Zgjidhja e konflikteve

Në rast konflikti, do të nisë një proces "ndërmjetësimi", ku Komitetit Drejtues dhe/ose Zyrës Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim në Tiranë mund t'u kërkohet të ndërmjetësojnë. Në rast se ky "ndërmjetësim" është i pasuksesshëm, do të arbitrojë një "komitet arbitrazhi i përbërë nga tre anëtarë, një i zgjedhur nga secila nga dy palët dhe një i tretë i dakordësuar reciprokisht nga dy anëtarët e komitetit". Partnerët e këtij Memorandumi Bashkëpunimi do të pranojnë vendimin e komitetit të arbitrazhit si të detyrueshëm.

Numri i kopjeve të Marrëveshjes

Ky Memorandum hartohet në tre kopje: dy në gjuhën shqipe dhe një në gjuhën angleze.

Pogradec, me _____

Bashki të Forta

Bashkia Pogradec

Norbert Pijls
Menaxheri i Projektit

Ilir Xhakolli
Kryetari i Bashkisë

